

Shoqata “Ndihamoni Jetën”, është një organizatë kombëtare me një eksperiencë prej 20 vjetësh në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, ofrimit të Shërbimeve të aftësimi për jetën të fëmijëve dhe të rinjëve me aftësi të kufizuar, në Qendër ditore, komunitet edhe gjithëpërfshirje në sistemin arsimor.

Shoqata do të implementoj projektin **“Rruga drejt jetesës së pavarur/Pathing the Way to eard the Independent Living”** në kuadër të projektit **“Askush të Mos Mbetet Pas/Leave No One Behind (LNB)”**, një Projekt i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara, i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatuar nga katër agjencitë e OKB-së UNDP, UNFPA, UNICEF dhe UN Eomen, në partneritet me Qeverinë Shqiptare, që synon të fuqizojë personat vulnerabël në Shqipëri të kenë akses dhe mundësi të barabarta në shërbime publike, të kenë një zë në vendimmarrjen publike, të drejta që ndikojnë në jetën e tyre, të mbajnë përgjegjësi dhe tu njihet kjo drejtë.

Qëllimi I këtij projekti është të “Mundësoj personave me aftësi të kufizuara intelektuale përmes shërbimeve efektive mbështetëse, të ushtrojnë të drejtën e tyre për të jetuar të pavarur në komunitet.

Objektivat e projektit janë:

1. Modelimi I një Shërbimi mbështetës për personat me aftësi të kufizuar intelektuale për të ushtruar të drejtën e tyre për të jetuar të pavarur në komunitet, si pjesë e Shërbimeve Komunitare.
2. Pilotimi i këtij Modeli të Shërbimit, me qëllim ndarjen e mëtejshme të tij me Institucionet Shtetërore përkatëse, për miratimin dhe replikimin e tij në vend.

Projekti kërkon të punësojë 1 Psikolog (me kohë të plot) I cili do të ofroj asistencën e tij për të rinjtë me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre, të targetuara nga ky projekt.

Përgjegjësitë specifike:

1. Psikologu, si pjesë e ekipit multidisiplinar, vlerëson gjendjen e të rinjëve me AK, harton Planin Edukativ Individual (PEI) në fushat e zhvillimit të fëmijës si edhe vendos objektivat për nderhyrjen në drejtim të:
 - problemeve psiko-emocionale dhe shkallës së zhvillimit të tyre,
 - nivelit të kapaciteteve njohëse dhe kapaciteteve në fusha të ndryshme të zhvillimit,
 - problemeve të sjelljes, ritualët, stereotipet, agresivitetin apo çrregullimet shqisore, etj

- identifikon pikat e forta dhe pikat e dobëta të përfituesit,
 - përcakton fushat e ndërhyrjes për programin e jetesës së pavarur
2. Ofron këshillim psikologjik dhe mbështetjes për të rinjtë me aftësi të kufizuara, për tu përshtatur sa më shpejtë në fazën tranzitore drejt një jetese të pavarur.
3. Informon dhe mbledhë ekipin multidisiplinar, sipas kalendarit të përcaktuar të takimeve, në momentet e ri-vlerësimit të aftësive dhe nevojave të përfituesve, bazuar në rezultatet e arritura përmes objektivave të vendosura në PEI.
4. Ofron mbështetje psikologjike për të rinjtë me aftësi të kufizuara duke u bazuar në PEI me qëllim:
- nxitë aftësitë e përshtatjes,
 - rritjen e aftësive për të jetuar në komunitet.
 - rritjen e aftësive socializuese dhe të bashkëpunimit.
 - rritjen e aftësive të kujdesit ndaj vetes dhe ambientit ku jeton.
5. Ofrimin e këshillimit psikologjik dhe mbështetjes për anëtarët e familjeve të të rinjëve me aftësi të kufizuara, që do të përfshihen në programin e jetesës së pavarur, për të kuptuar thelbin e shërbimit, të drejtën e fëmijëve të tyre për të zhvilluar një jetë sa më të pavarur, si edhe krijimin e partneritetit me familjen.
6. Të zhvilloj takime me familjen e përfituesve me aftësi të kufizuara me qëllim:
- Vlerësimin e kushteteve psiko-emocionale të kujdestarit, si ato ndikojnë tek zhvillimi i fëmijës, si edhe përmirësimi i gjendjes së tij/saj.
 - Analizimin e marrëdhënies së anëtarëve të familjes me personin me aftësi të kufizuara dhe impaktin e dinamikave të marrëdhënies ekzistuese.
 - Ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për tu ndërgjegjësuar mbi sfidat e pritshme të procesit në të cilin po përfshihet personi me aftësi të kufizuara.
 - Mbështetjen e familjes në forcimin e marrëdhënies së tyre me personin me aftësi të kufizuara.
 - Këshillimi i motrave/vëllezërve të fëmijëve me AK që të pranojnë dhe ndihmojnë zhvillimin e vëllait/motrës së tyre me AK,
7. Të ndjek të rinjtë gjatë zhvillimit të aktivitetit të tyre ditor, duke mbështetur stafin mbështetes në hartimin e objektivave specifike dhe programeve të duhura, për të ndihmuar zhvillimin e personave me aftësi të kufizuara.

8. Së bashku me anëtarët e tjerë të ekipit kontribon në rritjen e ndërgjegjësimit të anëtarëve të komunitetit për sensibilizim, kryesisht për ndryshimin e qëndrimeve përkundrjet personave me aftësi të kufizuara.

9. Ndjek dhe raporton tek Supervizori për realizimin e aktiviteteve sipas planit kohor.

10. Kohëzgjatja e Kontratës:

- 8 Muaj

11. Orari i punës:

Orari I punës do të jetë 8 ore në ditë/ 5 ditë në javë sipas një grafiku të mirepërcaktuar:

Orari:

08.00-16.00

14.00-22.00

20.00-06.00

Kualifikimi:

- ❖ Të jetë i/e diplomuar (bachelor dhe master) në Psikologji.
- ❖ Të ketë ndjekur trajnime kualifikuese shtesë në fushën e aftësisë së kufizuar..
- ❖ Të ketë jo më pak se 3 vite eksperiencë pune në ushtrimin e profesionit të tij/saj në Qendra që ofrojnë shërbime për personat me aftësi të kufizuar.
- ❖ Të ketë eksperiencë pune në ekip multidisiplinar për vlerësim dhe ngritje PEI (Plan edukativ individual).
- ❖ Të ketë aftësi shumë të mira komunikimi.
- ❖ Të jetë njohës i mirë i gjuhës angleze.
- ❖ Të ketë njohuri dhe aftësi të avancuara në paketën MS Office.

Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kriteret e parashkruara në këto Terma Reference, mund të dorëzojnë dokumentat e mëposhtëm brenda datës 08/06/2019, ora 16.30 me orën lokale.

- Letër motivimi që shpjegon motivimin tuaj për të aplikuar për këtë pozicion

- CV e detajuar



*Empowered lives.
Resilient nations.*

Vetëm kandidatët e përzgjedhur për fazën e intervistës do të njoftohen.

Aplikimet tuaja mund ti dërgoni në këtë adresë e-maili: info@helphelife.org.al